



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 13341 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

UDHËZIM

Nr. 32, datë 29.12 2017

PËR

“DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 03.08.2016 “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT”.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara, jashtë vendit”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në Pikën 1 të Kreut III, germa “d”, ndryshon si më poshtë vijon:

“d) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).”

2. Në pikën 2 të Kreut III, germat “c”, “d”, “e” dhe “f”, shfuqizohen.

3. Në pikën 2 të Kreut III, germa “g”, ndryshon si më poshtë :

“g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).”

4. Në pikën 3 të Kreut III, germat “d”, “f” dhe “i”, shfuqizohen.

5. Në pikën 3 të Kreut III, germa “g”, ndryshon si më poshtë :

“g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).”

6. Në pikën 3 të Kreut III, pika “iii”, në germën “h”, ndryshon si më poshtë :

“iii. Botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.”

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

